



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 695/5 prot.

Tiranë më 07.9.2022

VENDIM

Nr. 26, datë 07.9.2022

PËR KONTROLLUESIN “BYROJA SHQIPTARE E SIGURIMIT”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Byroja Shqiptare e Sigurimit” (në vijim, “Kontrolluesi” ose “BSHS”).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 52, datë 01.04.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i procesit të përpunimit të të dhënave personale në kuadër të aksesit që ka Kontrolluesi në të gjitha databazat shtetërore veçanërisht në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe zbatimi i detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit nr. 06, datë 23.01.2015 të Komisionerit.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. BSHS është person juridik i krijuar jo për qëllime fitimi dhe përmbush funksionet e veta në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar; Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin

e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, Rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove dhe Statutit të BSHS.

Anëtarë të *“Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të licencuar që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimit sipas ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. BSHS është anëtare e organizmit ndërkombëtar “Këshillit të Byrove”, dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësia në këtë këshill.*

Kontrolluesi në përmbushje të detyrimeve që derivojnë nga dispozitat e ligjeve të fushës së veprimtarisë dhe funksioneve të veta, administron Fondin e Kompensimit. Palët e dëmtuara në një aksident automobilistik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, shkaktuar nga një mjet i pasiguruar apo i paidentifikuar, kanë të drejtën të paraqesin kërkesë për dëmshpërblim nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, e konkretisht Fondi i Kompensimit. Kontrolluesi gjithashtu administron edhe Fondin e Kartonit Jeshil. Një nga detyrat thelbësore të kontrolluesit, është furnizimi i Anëtarëve (shoqëritë e sigurimit) me Çertifikata Ndërkombëtare Sigurimi, (karton jeshil), sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli i Byrove. Kontrolluesi mbledh, përpunon dhe përpilon raporte statistikore lidhur me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, bashkëpunon me institucionet dhe strukturat shtetërore/publike për çështje që lidhen me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

2. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka akses të drejtpërdrejtë në sistemin elektronik të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Marrja e informacionit në kuadër të kërkesave për verifikimin e të dhënave për nevoja (vendbanimi/vendqëndrimi për personat shkaktarë/përfitues) të një procedure dëmshpërblimi nga ana e Kontrolluesit bëhet përmes korrespondencës shkresore.

Në lidhje me aksesin në regjistrin e Qendrës së Informacionit të Sigurimeve të Detyrueshme, Kontrolluesi kryen vetëm procedurën e konfirmimit të mbulimit për automjete të cilat rezultojnë shkaktare në aksidente objekt të BSHS-së. Konfirmimi i ekzistencës së një police TPL, e cila bëhet përmes një kërkimi në link-un e sjellë nga Autoriteti, pasi me herët përcillet një kod sigurie në postën elektronike zyrtare të Byrosë.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se, në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale në mënyrë mekanike dhe elektronike. Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen, janë:

- Të dhënat e individëve të ndryshëm përfitues dëmsh, familjarë, trashëgimtarë;
- Të dhënat e individëve shkaktarë dëmsh;

- Ekspertë vlerësues dëmsh shëndetësore dhe materiale;
- Punonjës të BSHS dhe anëtarë të asamblesë;
- Klient përfitues të certifikatës ndërkombëtare të sigurimit motorik (karton jeshil);
- Nëpunës, vizitorë, etj.

Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të parashikuar një afat konkret të ruajtjes së të dhënave personale si për të dhënat e ruajtura në arshivën fizike po ashtu edhe në sistemin elektronik. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga kontrolluesi në funksion të detyrimeve që derivojnë nga dispozitat e ligjeve, sikurse edhe të dhënat e grumbulluara për Fondin e Kompensimit dhe Fondin e Kartonit Jeshil, kryesisht për kategoritë individëve të ndryshëm përfitues apo shkaktarë dëmsh, klientë, etj., përpunohen/ruhen që nga koha e paraqitjes së “*Kërkesës për Dëmshpërblim*”, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale parashikuar në germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara nga Kontrolluesi në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, si “*ent kompesues*” për dëmet e shkaktuara në Republikën e Shqipërisë, duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e mbajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi nuk ka vendosur “*Politikat e Privatësisë*” në faqen zyrtare <https://www.insurers-al.org/> me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në këtë faqe. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit. Gjithashtu, nga verifikimi i “*Kërkesës për Dëmshpërblim*”, të publikuar në faqen zyrtare <https://www.insurers-al.org/> të Kontrolluesit, rezulton se, subjektet e të dhënave nuk informohen sipas parashikimit ligjor të mësipërm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare, ka detyrimin që të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes online të internetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e

këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush më së miri qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (ambienti i recepsionit) dhe të jashtme, për qëllim të sigurisë së nëpunësve dhe aseteve. Mbikëqyrja e ambientit të jashtëm të BSHS, përveç derës së jashtme të zyrave, përfshinë edhe shkallët e pallatit, me mundësi fokusimi edhe të banorëve të pallatit. Ky konstatim është në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, kamerat mund dhe duhet të përdoren në mënyrë që të synojnë vetëm identifikimin e qartë të problemeve të sigurisë së Kontrolluesit, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur fokusimin e imazheve të panevojshme të cilat tejkalojnë qëllimin e përpunimit, i cili duhet të specifikohet qartë dhe të jetë në përputhje me interesat ligjore të Kontrolluesit. Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se kontrolluesi ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, të tilla por pa u kufizuar si “Imazhe nëpërmjet kamerave të Vëzhgim-Regjistrimit (CCTV)”, etj.;
- Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “Qëllimi i përpunimit të të dhënave”, të tilla por pa u kufizuar si “Sigurinë e ambienteve”, etj.

- Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Marrësi i të dhënave personale*”, të tilla por pa u kufizuar si “*shoqëritë e sigurimeve, kompania që ofron shërbime mirëmbajtje*”, etj.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale në mënyrë elektronike nëpërmjet “*Sistemit të Administrimit të Dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit*”. Ky sistem është i përbërë nga dy module/regjistra të cilat pasurohen me të dhëna, për llogari të “*Fondit të Kompensimit*” dhe “*Fondi të Kartonit Jeshil*”. “*Sistemi i Administrimit të Dëmeve*”, shërben për regjistrimin elektronik të dosjeve të dëmeve për rastet e shkaktuara nga mjetet e pasiguruara/paidentifikuara, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 32/2021. Konstatohet se, serverat ku ngrihet “*Sistemi i Administrimit të Dëmeve*”, nuk ndodhen fizikisht në ambientet e kontrolluesit, por aksesohen nga punonjësi i ngarkuar nëpërmjet IP tunel. “*Sistemi i Administrimit të Dëmeve*”, funksionon në bazë të Rregullores “*Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit*”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 105, datë 30.06.2021 të AMF-së. Niveli i informacionit dhe aksesit të informacionit për përdoruesit rregullohet sipas nenit 6 të kësaj rregullore, sipas të cilit:

- ✓ Përdoruesi i brendshëm i Byrosë ka të drejta editimi të dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 41 dhe 59 të Ligjit nr. 32/2021;
- ✓ Përdoruesi i brendshëm i shoqërisë së sigurimit ka të drejta editimi të dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 43 të Ligjit nr. 32/2021;
- ✓ Përdoruesi i jashtëm ka vetëm të drejta leximi të informacionit, pa mundësi ndryshimi.

Përdorues të sistemit, sipas këtij kuadri ligjor, janë edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Shoqëritë e Sigurimeve, vetëm për dëmet të cilat trajtojnë për llogari të “*Fondit të Kompensimit*” dhe “*Kartonit Jeshil*”.

Të dhënat personale që përpunohen, në “*Sistemin e Administrimit të Dëmeve*”, janë të dhënat që grumbullohen në funksion të trajtimit të praktikës së dëmit për përfituesit. Një praktikë dëmi midis të tjerave përmban të dhëna për ndodhinë e aksidentit,

gjeneralitetet e shkaktarit të ngjarjes, gjeneralitetet e përfituesit, vendime gjyqate, të dhëna të automjetit të shkaktarit, të dhëna të automjetit të përfituesit, të dhëna shëndetësore, etj.

Nga verifikimet on-site të Kontrolluesit, u konstatua se është vetëm një person përgjegjës (me detyrë specialist IT) i cili popullon me të dhëna "*Sistemin e Administrimit të Dëmeve*". Ky punonjës nuk ka atribut në sistem, në rolin e administratorit me të drejta të plota, si dhe nuk është në gjendje të identifikojë apo gjurmtojë veprimtarinë e palëve të treta që kryejnë veprime në sistemin elektronik nëpërmjet "*events\log-e*". Si rrjedhojë, Kontrolluesi nuk është në gjendje të kryejë veprime proaktive teknike në sistemin elektronik me qëllim verifikimin dhe monitorimin e funksionimit të këtij sistemi në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përgjegjësia për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale qëndron te Kontrolluesi që administron këtë sistem. Një nga masat kryesore për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave është edhe gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese dhe verifikimi i vazhdueshëm i saj, me qëllimin për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese është i rëndësishëm për t'i mundësuar Kontrolluesit realizimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore për të garantuar konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale të cilat përpunon, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore specifike. Kjo për të shmangur edhe pasojat e rënda që mund të vijnë në rast të aksesit ose përhapjes së paligjshme të të dhënave nga palë të treta, që kanë akses në të dhëna.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve dhe sistemeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 dhe 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, të Komisionerit, datë 14.09.2018 "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*").

6. Kontrolluesi ka deklaruar se, administrimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi e ka deleguar te operatori ekonomik "*Tetra Solutions shpk*". Nga grupi i kontrollit u kërkua verbalisht gjatë hetimit, sikurse edhe nëpërmjet postës elektronike, një kopje e kontratës së delegimit të shërbimit për këtë sistem.

Kontrolluesi nuk e vendosi në dispozicion të grupit të inspektimit kontratën me operatorin ekonomik *“Tetra Solutions shpk”*, për pasojë nuk ka arritur të dokumentojë se, për përpunimin e të dhënave personale, ka punësuar/kontraktuar *“përpunues”*, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit. Kjo në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të ligjit si dhe Udhëzimin nr. 19, datë 03.08.2012, mbi *“Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratoj një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikim e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19.

7. Kontrolluesi disponon Rregullore *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* të miratuara me Urdhrin e Brendshëm nr. 345 datë 31.12.2019, por konstatohet se, përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale dhe sensitive që përpunon Kontrolluesi, kategorive të subjekteve të të dhënave në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit si dhe Vendim nr. 6, datë 05.08.2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”* (në vijim *“Vendimi nr. 6”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Hartimi i një rregulloreje standarde për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilën mungojnë rregullat e qarta për garantimin e mbrojtjes, përpunimin, ruajtjen dhe

sigurinë e të dhënave personale, e lidhur specifikuisht me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen Kontrolluesi, nuk përmbush kërkesat e Ligjit.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

9. Lidhur me verifikimin mbi zbatimin e Rekomandimit nr. 6 datë 23.01.2015 për kontrolluesin *“Byroja Shqiptare e Sigurimeve”*, rezulton se kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të Rekomandimit. Konkretisht:

1. *[...Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Byroja Shqiptare e Sigurimit”, të përditësojë Formularin e Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit, në të gjitha rubrikat e plotësuara me mangësi, apo ato të palpotësuara fare..]*
2. *[...Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, kontrolluesi Byroja Shqiptare e Sigurimit, gjatë mbledhjes, përpunimit të dhënave personale, nëpërmjet policave të sigurimit të detyrueshëm të realizojë informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit të tyre etj...]*

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 695/3 prot., datë 22.06.2022.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku parashtrori se qëndrimin mbi konstatimet e Grupit të hetimit do ta paraqesë me shkrim.

Me shkresën nr. 2649 prot., datë 05.07.2022, Kontrolluesi parashtrori argumentet si më poshtë:

- *Lidhur me konstatimin e pikës 7 të procesverbalit, Kontrolluesi informon se, e vlerëson korrekt konstatimin e grupit të inspektimit dhe ka marrë masa për të korrigjuar mangësitë e konstatuara, duke printuar dhe afishuar në derën hyrëse të institucionit njoftimin se ambienti survejohet me kamera.*

Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e Kontrolluesit për të recuperuar shkeljet e konstatuara, por kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia administrative, në rastin konkret, për shkak se detyrimi duhet të ishte plotësuar paraprakisht nga kontrolluesi, në përmbushje të detyrimeve të ligjit. Njëkohësisht, edhe njoftimi i afishuar, se ambienti survejohet me kamera, nuk është i plotë dhe në përputhje me modelin standard të tabelës informuese të miratuar nga Zyra e Komisionerit në përputhje me Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"

- *Lidhur me konstatimin e pikës 5 të procesverbalit (koha e ruajtjes së të dhënave), Kontrolluesi sqaron se, ekziston një justifikim i posaçëm ligjor për mbajtjen dhe administrimin për një periudhë të gjatë në kohë të praktikave të aksidenteve objekt të BSHS, konkretisht për:*
 - *Ekzekutim të titujve që derivojnë nga një akt administrativ dhe/ose që derivojnë nga një vendim gjykate i formës së prerë, dhe kjo e drejtë është e paparashkrueshme për përfituesin e dëmit.*
 - *Regresimin nga shkaktaret e aksidenteve të vlerës së dëmit të parapaguar nga BSHS në favor të të dëmtuarve.*

Lidhur me pretendimet e parashtruara nga Kontrolluesi, se është në kushtet e pamundësisë ligjore për të përcaktuar afat për ruajtjen e të dhënave, Zyra e Komisionerit vlerëson se, i takon vet Kontrolluesit të marrë masa për përcaktimin dhe rregullimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit rast pas rasti, në mbështetje të ligjeve apo akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarisë.

- *Lidhur me konstatimin e pikës 10 të procesverbalit, bashkëlidhur pretendimeve të paraqitura me shkrim nga ana e Kontrolluesit është vendosur në dispozicion Kontrata e shërbimit me operatorin “Tetra Solution SHPK”.*

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës me këtë operator, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga ana e Kontrolluesit nuk janë përmbushur detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit. Të gjitha detyrimet e sanksionuara në këtë nen duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e shkruar mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit dhe të përshtaten sipas objektit të vecantë të veprimtarisë dhe ndërveprimit ndërmjet palëve.

Çdo kontratë përpunimi (outsourcing) që ka për qëllim delegimin e përpunimit e të dhënave personale duhet të përmbaj dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Çdo kontratë e tillë duhet të parashikoj masat që duhet të marr përpunuesi për të siguruar/garantuar mbrojtjen e të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

- Lidhur me konstatimet e tjera të parashtruara në procesverbal, rezulton se nga ana e Kontrolluesit nuk janë paraqitur argumente apo prova të tjera shtesë.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a. kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b. kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- ç. kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d. kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh. kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze, dhe Kontrolluesi është në kushtet e nenit 30/2 të përsëritjes së shkeljeve dhe moszbatimit të Rekomandimeve të Komisionerit. Pranë Kontrolluesit është ushtruar më herët hetim administrativ, ku Komisioneri nëpërmjet Rekomandimit nr. 06, datë 23.01.2015, ka orientuar Kontrolluesin për rikuperimin e shkeljeve të cilat binin ndesh me nenet 18 dhe 21 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, germat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë), për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
- 5- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 240 000 (dyqind e dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi të rishikojë procesin e përpunimit të të dhënave personale, duke marrë masa për përcaktimin dhe rregullimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën "d", të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;

- 8- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave, etj;
- 9- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
- 10- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 11- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 12- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 13- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 7 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 8, 9, 10 më sipër;
 - (iii) Vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 6 më sipër;
 - (iv) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 11 më sipër;
 - (v) Brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 12 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti.

- 14- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 15- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
- 16- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 07.9.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

